

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektligjit, kryesisht mbi:

- Parashikimin për kodin unik të adresës, i cili identifikon në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese apo trualli të lirë, në shkallë vendi.
- Vendosjen e aplikimit të sanksioneve administrative për procesin e emërimit dhe numërimit me tabelat përkatëse, kundrejt bashkive që nuk kryejnë procesin.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen në projektligj.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 1 muaj, nga data 26 tetor 2023 deri më 26 nëntor 2023.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Irida Zogolli - Përgjegjëse, Drejtorja e Hartimit të Procedurave dhe Kontrollit, DPGJC
e-mail: Irida.Zogolli@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 66, datë 16.05.2023 të Ministrit të Brendshëm “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar””.
- Në Ministrinë e Brendshme, më datë 25.01.2023, është zhvilluar mbledhja e pare e grupit ndërinstitucional të punës, e kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2022 “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrin Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.
- Më pas grupi i punës është mbledhur dhe në datë 9 shkurt 2023 dhe 23 mars 2023 për identifikimin e grupeve të interesit dhe përcaktimit të metodave të konsultimit.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji ka si qëllim zgjidhjen e problematikave të krijuara nga mosangazhimi i strukturave përkatëse në respektim të detyrimeve ligjore në proceset e emërimit dhe të numërimit të pjesëve të territorit publik.

Adresimi i pjesëve të territorit publik është një proces shumë i domosdoshëm për menaxhimin urban dhe për orientimin e shtetasve në zonën që ata vetë banojnë, apo dhe kur vizitojnë, qarkullojnë në zona të tjera.

Propozimet

Projektligji synon zgjidhjen e problematikave të krijuara deri më tani për sistemin e adresave në territorin e Republikës së Shqipërisë, që kryesisht derivojnë nga mosndjekja e procesit të emërimit nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, bashkitë, si dhe në vijim të porosisë së Kryeministrit, nëpërmjet së cilës është përcjellë aplikimi i sanksioneve të forta ndaj bashkive që nuk përmbushin këtë proces, i parashikuar për t’u përmbyllur që në vitin 2016.

Përmbushja e kësaj detyre është sanksionuar në dispozitat sipas pikës 2 të nenit 29 të ligjit aktual, ku shprehimisht parashikohet se: “Seksionet/zyrat e urbanistikës në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bëjnë adresim numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, brenda datës 31 dhjetor 2016”, miratuar me ligjin nr.89/2016, datë 15.09.2016 dhe që nuk është përmbushur deri më tani.

Procesi i emërimit të pjesëve të territorit publik i vjen në ndihmë shtetasve të lokalizojnë një ndërtesë/apartament, një rrugë, një shesh, një park, një biznes, një zyrë shërbimi, etj.

Projektligji përbëhet nga 14 nene.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si e vlerësoni përcaktimin në projektligj mbi mbulimin e shpenzimeve për tabelat e numërtimeve nga pronari i ndërtesës?
- A jeni dakord me parashikimin se sanksioni kundrejt kryetarëve të bashkisë do të vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile për pjesë të territorit publik të cilat do të rezultojnë të panumërtuara?